



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM


Nr. 228, datë 13.07.2021

**PËR PRAKTIKËN PROFESIONALE TË KANDIDATËVE PËR MAGJISTRATË
TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

Bazuar në nenet 14 dhe 33 të Ligjit Nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të caktojë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, si zyra që do të shërbejnë për kryerjen e praktikës profesionale për kandidatët magistratë, profili prokuror, të vitit akademik 2021-2022.
2. Të caktojë/miratojë magistratët prokurorë udhëheqës për një periudhë 1 vjeçare (2021-2022) me të drejtë riemërimi, sipas listës bashkëlidhur (aneksi nr.1).
3. Magistratët prokurorë udhëheqës sipas pikës 2, të angazhohen menjëherë për të ndjekur trajnimet e nevojshme pranë Shkollës së Magjistraturës.
4. Këshilli të caktojë, për periudhën korrik 2021- qershor 2022 magistratët prokurorë udhëheqës, për kandidatët për magistratë profili prokuror, për vitin akademik 2021-2022, sipas listës bashkëlidhur (aneksi nr.2).
5. Magistrati prokuror udhëheqës bën vlerësimin etik dhe profesional të secilit kandidat magistrat, profili prokuror, duke u bazuar në kriteret dhe nivelet e vlerësimit, të përcaktuara në ligj.
6. Magistrati prokuror udhëheqës, përgjatë periudhës përkatëse që ushtron këtë veprimtari përfiton 5 për qind shtesë page mbi pagën mujore bruto fillestare të tij.
7. Gjatë praktikës profesionale, kandidati për magistrat, profili prokuror, gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara në kohëzgjatjen 25 ditë pune, nga të cilat, 15 ditë pune merren gjatë muajit gusht, në të njëjtën kohë me magistratin udhëheqës. Drejtuesi i prokurorisë jep pushimet vjetore, pasi konsultohet me magistratin udhëheqës të tij.

- 
8. Të njoftohen për këtë vendim Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë si dhe magistratët prokurorë udhëheqës.
 9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

